



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 3519/2 Prot.

Gramsh, më 09. 09. 2025

V E N D I M

Nr. 82 , datë 09/09/2025

PËR
DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE TË DHËNIES NË
PËRDORIM FOND PYJOR, PËR VENDOSJE OBJEKTESH TË NDRYSHME
NDIHMËSE NË SIPËRFAQE, NË FUNKSION TË NDËRTIMIT TË HEC GRABOVA 1
NGA SHOQËRIA "GRABOVA HYDROPOËËR"shpk

Këshilli Bashkiak Gramsh në mbledhjen e tij të datës 09.09.2024, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, Sektori i Administrimit të Pyjeve, mbështetur në ligjin nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr.107/2014, datë 03.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për Pyjet", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.684, datë 02.09.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.433, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive", të ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.267, datë 27.04.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.559, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", shtojca nr.1 (tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtaritë e ushtruara në këtë fond), të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.01, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.3607 ha (3607 m²) fond pyjor publik, për vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe, nyje betoni, ngastra pyjore nr.104/c, ekonomia pyjore "Dushku i Bulçarit", zona

kadastrale 1266, nr pasurie 74, nga shoqëria "Vëllezrit Hysa" shpk, në kuadër të ortakërisë me shoqërinë Grabova Hidropoër shpk, në funksion të ndërtimit të Hec Grabova I.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Pyjeve, Bujqësisë dhe Turizmit, Sektori i Administrimit të Pyjeve, si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë Bashkisë Gramsh.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

SEKRETARI I KËSHILLIT

XHULIA GJINI



Në Mungesë dhe me Urdhër
Zv/Kryetari



KRYETARI I KËSHILLIT

ENIS ZANI